



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	01
NR.PROT. BR.PROT. NR.PROT.	155
NUMRI I FAQEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	06
DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:	30/06/2020
PRISHTINË / A	

Rregullore Nr. 03/2020 për Licencim

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi është që përmes rregullave të përcaktuara në këtë akt nënligjorë, ARH-ja të paraqesë procedurat dhe kriteret që duhet të përmbushën në procesin e aplikimit për licencë, në mënyrë që procesi të jetë i qartë dhe transparent.

2. Po ashtu kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj disa nga kriteret që mbajtësit e licencës janë të obliguar që t'i plotësojnë në vazhdimësi edhe pas marrjes së licencës.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjitha aplikacionet për licencë nga menaxher të infrastrukturës dhe ndërmarrje hekurudhore. Operimi në hekurudha pa një licencë adekuate do të konsiderohet e kundërligjshme bazuar në Ligjit e Hekurudhave.

Neni 3

Organi i Licencimit

ARH është organi i pavarur përgjegjës për licencim në sektorin hekurudhor të Kosovës sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës. Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm, ju lutem vizitoni ueb faqen e ARH-së.

Neni 4

Llojet e Licencave në Kosove

ARH lëshon licenca për menaxhim të infrastrukturës, transport hekurudhor të udhëtarëve, transport hekurudhor të mallrave dhe licenca të reja për makinist. Licencimi i makinistëve rregullohet me një akt tjetër nënligjorë.

Neni 5

Fushëveprimi i licencave

Licencat autorizojnë operimin kudo në Kosovë vetëm nëse certifikata përkatëse e sigurisë dhe/apo autorizimi i sigurisë janë marrë. Licenca si dokument i vetëm nuk i jep të drejtë operimi askujt në infrastrukturën hekurudhore të Kosovës, nëse përveç licencës nuk janë përmbushur edhe kushtet tjera ligjore për operim.

Neni 6

Licencat e huaja të vlefshme në Kosovë

Licencat e vlefshme të lëshuara për operim hekurudhor nga ndonjë organ licencues i Bashkimit Evropian, vendet regjionale, apo vendet e treta do të jenë të vlefshme në Kosovë, nëse janë në përputhje me legjislacionin e Kosovës, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit të Hekurudhave, Udhëzimin Administrativ Nr.17/2017 për plotësim dhe ndryshim të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për licencimin e operatorëve të transportit hekurudhore dhe Udhëzimin Administrativ Nr.18/2017 për plotësim dhe ndryshim të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për licencimin e menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore.

Neni 7

Kohëzgjatja e Licencës

Licencat nuk kanë afat të caktuar, mirëpo të njëjtat janë të vlefshme deri sa të gjitha kushtet për marrjen e licencës vazhdojnë të përmbushen nga mbajtësi i sajë.

Neni 8

Aplikacioni

1. Për të trajtuar një aplikacion në afatin e duhur kohor, i njëjti duhet të jetë i kompletuar. Në momentin që aplikacioni kompletohet, brenda tre (3) muajsh ARH do të marrë vendim lidhur me kërkesën për licencë.
2. Për aplikimin për licencë duhet të përdoret formular zyrtar i aplikimit që mund të merret në ueb faqe apo në zyrat e ARH-së dhe i cili dorëzohet dhe protokollohet në ARH.
3. Dhënia e informatave të pasakta apo fshehja e tyre në momentin e aplikimit, nëse zbulohen nga ARH do të rezultojnë në refuzim të aplikacionit, dhe rasti mund të adresohet tek organet e ndjekjes.
4. Në rast se licenca është marrë në bazë të informacioneve jo të vërteta në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës, ARH mund ta revokoj licencën.

Neni 9

Procedura

Nëse aplikacioni është i kompletuar me të gjitha shënimet dhe dokumentacionin e nevojshëm, ARH do të filloj shqyrtimin e tij brenda një kohet të arsyeshme, por që vendimi gjithsesi do të merret brenda afatit të paraparë ligjore prej tre (3) muajsh.

Neni 10

Bisedimet paraprake

Meqenëse procedurat e aplikimit mund të jenë të ndërlikuara, para se të bëhet dorëzimi i aplikacionit për licencë, në mënyrë që i njëjti të jetë i kompletuar ashtu siç kërkohet, palët e interesuara mund të kërkojnë sqarime nga zyrtarët e ARH-së, përmes takimeve zyrtare në zyrat e ARH-së.

Neni 11

Konfidencialiteti

Aplikuesi për licencë duhet të kërkoj shprehimisht se cila nga informatat/dokumentet të sjella me aplikacion duhet të trajtohet si konfidenciale nga ana e ARH-së.

Neni 12

Njoftimet

Ne do të njoftojmë Ministrinë e Ambientit dhe Infrastrukturës kur të kemi marrë vendimin për lëshimin e licencës së re.

Neni 13

Kriteret e licencimit

1. Në mënyrë që kërkesa për licencë të konsiderohet e plotësuar, aplikuese duhet të plotësoj kushtet që kanë të bëjnë me reputacionin e mirë, të ketë përshtatshmëri financiare, të ketë kompetencë profesionale nga fusha e sigurisë dhe të jetë i mbuluar me sigurim adekuat.
2. Të licencuarit gjithashtu duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë zbatueshmërinë e duhur në vazhdimësi të gjitha kushteve të licencimit. Dështimi për të përmbushur njërin apo disa nga kushtet e licencimit, do të rezultojë në pezullim apo revokim të licencës.

Neni 14

Sigurimi

1. Sigurimi duhet të jetë në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, të përgjegjësive për mbajtësit e licencës në rast të aksidentimit të pasagjerëve, bagazhit, mallrave, postës dhe palëve të treta.
2. Në mënyrë që sigurimi i juaj të jetë adekuat siç kërkohet nga Ligji për Hekurudhat e Kosovës dhe përcaktimi i minimumit i kërkuar nga Rregullorja e BE-së 2015/171, minimumi që polica

e sigurimit duhet të mbulojë nga secili bartës i licencës është treqind mijë euro 300,000.000 € brenda periudhës një (1) vjeçare.

3. Në rast të shpeshtënit të aksidenteve dhe vërtetimit të fajësisë së mbajtësit të licencës, ku dëshmohet se sigurimi nuk i ka mbuluar të gjitha përgjegjësitë, ARH mund të rrisë pragun e sigurimit.

4. Po ashtu, në rast se sigurimi juaj nuk i mbulon të gjitha përgjegjësitë ndaj palëve të treta për aksidentet apo incidentet e ndodhura, kompania juaj to jetë përgjegjëse për mbulimin e të njëjtave jashtë policës së sigurimit, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 15

Ndryshimi i kontrollit

1. Mbetësit e licencës duhet ta njoftoni ARH-në në rast të ndryshimit të kontrollit në kompaninë e licencuar.

2. Kur të drejtat e një personi, aksionari direkt apo indirekt për të votuar, tek një mbajtës i licencës rritet për më shumë se 25 % të operatorit, në Kosovë, kjo normalisht do të jetë ndryshim i kontrollit dhe si rrjedhojë duhet informuar ARH-në.

3. Një ndryshim kontrolli në një kompani që tashmë është e licencuar nuk nënkupton që një licencë e re duhet të lëshohet. Kjo është për shkak se identiteti ligjor i kompanisë do të mbetet i njëjti, madje edhe nëse pronarët kanë ndryshuar. Sidoqoftë ndryshimet mund të jenë fuqiplota me mundësinë e operatorit për të përmbushur obligimet e veta në mënyrën e duhur. Kështu që informatat e kërkuara në rast të ndryshimit të kontrollit janë të ngjashme me ato që kërkohen për aplikuesit e rinj.

4. ARH mund të revokoj një licencë nëse dikush që ARH kundërshton mbetet në kontroll të një operatori që ndikon negativisht në mundësinë për t'iu përmbajtur kushteve të licencës.

Neni 16

Monitorimi dhe zbatimi

1. Bartësit e licencave duhet përmbajtur kushteve që ndërliidhen me licencat e tyre gjatë gjithë kohës. Në veçanti ata duhet të përmbushin katër kriteret e licencimit të listuara në nenin 13 paragrafi 1 të kësaj rregullore.

2. ARH është kompetent për zbatimin e kushteve të licencimit dhe për të verifikuar përmbajtjen e kriterëve të licencimit, pasi që qëllimi i zbatimit të licencës është të sigurojë kryerjen dhe sigurimin e përputhjes me obligimet e interesit publik.

3. Nëse ekzistojnë dyshime apo ARH pranon informatë/njoftim në lidhje me atë se mbajtësit e licencës nuk u përmbahen ndonjërit prej kriterëve licencuese, ARH mund të bëjë hulumtime të mëtejme. Nëse licenca është aprovuar nga ndonjë organ tjetër e jo nga ARH, ne do t'i njoftojmë këto organe.

4. Mos përmbushja në vazhdimësi e të gjitha kushteve të licencës, mund të rezultojë në veprime verifikimi nga ana e ARH-së, që si përfundim mund të rezultojnë në pezullim apo revokim të licencës.

Neni 17 Transpozimi

Kjo rregullore transponon Direktivën e Bashkimit Evropian Nr. 2012/34 për krijimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane, pjesët që kanë të bëjnë me licencimin. Po ashtu, kjo rregullore transponon edhe Rregulloren implementuese të BE-së 2015/171 për procedurat dhe aspektet e licencimit, e cila derivon edhe si obligim nga Traktati i Komunitetit të Transportit, i nënshkruar nga Bashkimi Evropian dhe vendet ballkanike, përfshi Kosovën.

Neni 18 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Licencimit 01/2012.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të sajë.


Arsim Berisha,
Kryesues i Bordit të ARH-së.
Prishtinë, 30.06.2020.

